Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

02.10.2023, Prishtinë,
Ref:20.09.2023\1456-2023

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Bademe Berisha Baliqi kundër Nacionale

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 28 shtator 2023, shqyrtoi ankesën e dërguar nga Bademe Berisha Baliqi kundër Nacionale lidhur me publikimin e një videolajmi, dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa miratohet.

A R S Y E T I M

Media ka publikuar një videolajm, në të cilin intervistohet një person, pretendimet e të cilit ishin të ndryshme, përfshirë edhe akuza të drejtpërdrejta kundrejt ankueses dhe palëve të tjera. Ankuesja pretendon se nuk i është dhënë mundësia për t'u deklaruar dhe media ka shkelur Kapitullin IV (e drejta për t'u përgjigjet) të Kodit të Mediave të Shkruara.

Lajmi është video e medias së shkruar e transmetuar në web faqen dhe rrjetin social, andaj ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të ankesës, KMShK gjen se ankesa është e bazuar. Pra, miratohet.

KMShK ka dëgjuar me vëmendje intervistën dhe ankesën e palës.

KMShK vëren se publikut nuk i janë bërë me dije përpjekjet e medias për të kontaktuar palën ankuese. Media nuk e dëshmon në asnjë moment se e ka telefonuar apo kontaktuar ankuesen në lidhje me pretendimet e saj. Media duhet t'i bëjë të gjitha përpjekjet që ta kontaktojë palën dhe publikut t'ia bëjë me dije ato. Në rastin e videove, gazetarët duhet që gjatë realizmit të intervistës të njoftojnë publikun për tentativat dhe mundësitë që iu janë dhënë palëve të përmendura nga i intervistuari që të deklarohen për median. Është thelbësore që media të përpiqet që t'i përfshijë të gjitha palët në raportim. KMShK gjen se media ka shkelur Kapitullin IV të Kodit të Mediave të Shkruara dhe Online.

Andaj, KMShK vendos që ankesa të miratohet.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës